



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr. 2872/11 prot.

Datë 26.01.2024

V E N D I M

Nr.93/2024

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Jonaid Myzyri	Kryetar
Fiorent Zguro	Nënkryetar
Kreshnik Ternova	Anëtar
Anila Malaj	Anëtar

Në mbledhjen e datës 26.01.2024 me

Objekt:

Vendim për mbylljen e çështjes mbi ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik ‘RO-AL’ SHPK, në procedurën e prokurimit “E hapur” me nr. REF-79117-09-06-2023, me objekt “Blerje pajisje mobilimi për Qendrat Shëndetësore të Rikonstruara’ Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale”, me fond limit 35,203,770.00 leke pa TVSH, zhvilluar më datë 22.09.2023, nga autoriteti kontraktor, Agjencia Shtetërore e Prokurimeve të Përqëndruara.

Lënien të skualifikuar të ofertës së paraqitur nga operatori ekonomik “Ro-Al” SHPK në procedurën e prokurimit “E hapur” me nr. REF-79117-09-06-2023, me objekt “Blerje pajisje mobilimi për Qendrat Shëndetësore të Rikonstruara’ Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale”, me fond limit 35,203,770.00 leke pa TVSH, zhvilluar më datë 22.09.2023, nga autoriteti kontraktor, Agjencia Shtetërore e Prokurimeve të Përqëndruara.

Ankimues:

Operatori ekonomik “RO-AL” SHPK, nr. NIPT J61811001M
KM8, Autostrada Tiranë-Durrës

Operatori ekonomik “KLAME” SHPK nr. NIPT K21518003F
Adresa: Rruga “Gani Kryeziu”, Nr.23, Kati i dytë Njësia
Administrative nr.11, Kodër Kamëz.

Autoriteti Kontraktor: “Agjencia Shtetërore e Prokurimeve të Përqendruara”
Adresa Blv.“Dëshmorët e Kombit”, Nd. 1, 1001, Tiranë.

Subjekt i Interesuar: Operatori ekonomik “Ro-Al” SHPK me nipt J61811001M
Adresa: Km 8 ,Autostrada Tirane-Durrës .

Baza Ligjore: Ligji nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, e ndryshuar, Nenet 30 dhe 115 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766/2021, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, dhe nenit 4 të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID - 19”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi shqyrtoi informacionin e paraqitur

Vëren:

I

Vlerësimi Paraprak

I.1. Vlera limit e përlogaritur për procedurën e prokurimit objekt-ankimi është mbi kufirin e ulët monetar, ndaj shqyrtimi dhe vendimmarrja do të bëhet nga të gjithë anëtarët, në përputhje me pikën 1, të nenit 30 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” dhe Rregullat e Prokurimit Publik.

I.2. Pas shqyrtimit paraprak të ankesave, të mbështetur në dokumentacionin e dërguar nga operatorët ekonomikë ankimues, Komisioni i Prokurimit Publik konstatoi, se këta të fundit kanë qenë operatorë ekonomikë në të njëjtën procedurë prokurimi, ndaj edhe ankimet e tyre duhet të bashkohen e të shqyrtohen në një gjykim të vetëm.

1.3. Operatorët ekonomikë kanë *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohen për të paraqitur ankesë në lidhje me të.

I.4. Operatori ekonomik ankimues “KLAME” SHPK, nuk ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor, por ka paraqitur ankesë pranë Komisionit të Prokurimit Publik, jo në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”.

I.5. Operatori ekonomik ankimues “RO-AL” SHPK ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”.

1.6. Operatori ekonomik ankimues “KLAME” SHPK nuk ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë Komisionit të Prokurimit Publik.

II

Rrethanat e çështjes

II.1. Në datën 07.09.2023, është publikuar në Sistemin e Prokurimeve Elektronike procedura e prokurimit “E hapur” me nr. REF-79117-09-06-2023, me objekt “Blerje pajisje mobilimi për Qendrat Shëndetësore të Rikonstruara’ Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale”, me fond limit 35,203,770.00 leke pa TVSH, zhvilluar më datë 22.09.2023, nga autoriteti kontraktor Agjencia Shtetërore e Prokurimeve të Përqendruara.

II.2. Në datën 22.09.2023, autoriteti kontraktor ka zhvilluar procedurën e prokurimit.

II.3. Në datën 09.11.2023, autoriteti kontraktor ka kryer vlerësimin e ofertave dhe ka njoftuar operatorët ekonomikë pjesëmarrës me anë të sistemit të prokurimeve elektronike (S.P.E), mbi rezultatet e rivlerësimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, të cilët kanë paraqitur ofertat ekonomike (pa TVSH), përkatësisht:

1. Ro-AL SHPK	26999676 lek	Skualifikuar
2. KLAME SHPK	28857066 lek	kualifikuar
3. Bolt SHPK	29064990 lek	kualifikuar
4. Erzeni/Sh SHPK	30423960 lek	kualifikuar
5. Muca SHPK	31621115 lek	kualifikuar
6. Shaga SHPK	35124421.60 lek	Skualifikuar
7. Buna SHPK	Pa ofertë ekonomike	
8. EMKO SHPK	Pa ofertë ekonomike	

II.4. Në datën 10.11.2023, autoriteti kontraktor ka publikuar në SPE, Njoftimin e Fituesit Paraprak për procedurën e prokurimit objekt-ankimi.

II.5. Në datën 20.11.2023, në formë shkresore pranë Komisionit të Prokurimit Publik, është administruar ankesa me numër ankimi 2872, e operatorit ekonomik “KLAME”. Objekti i ankesës lidhet me vendimmarrjen e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, si dhe lënien të skualifikuar të operatorit ekonomik “Ro-AI” SHPK.

II.5.1. Në përputhje me nenin 112, “Veprimet paraprake” të Ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Komisioni i Prokurimit Publik me marrjen e ankesës, e publikoi atë në bazën e të dhënave të tij, e cila përmban të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës), si dhe publikoi formularin e publikimit nr. 2872/2 prot, datë 21.11.2023. Objekti i ankesës lidhet me lënien të skualifikuar të operatorit ekonomik “Ro-AI” SHPK.

II.6. Në datën 19.12.2023, nr. 2872/3 prot., Komisioni i Prokurimit Publik i dërgon shkresë autoritetit kontraktor, me lëndë “Mbi detyrimin e autoritetit kontraktor për dhënie informacioni KPP-së lidhur me ankesën e operatorit ekonomik ‘KLAME’ ShPK”.

II.7. Në datën 05.01.2024, Autoriteti Kontraktor nëpërmjet shërbimit postar, me shkresën nr. 11/1 prot., protokolluar në KPP me nr. 2872/4 prot., datë 09.01.2024, ka dërguar informacionin dhe vendimin e KSHA, lidhur me trajtimin e ankesës së paraqitur nga operatorët ekonomikë ankimues “KLAME” SHPK, ku citon “*Nuk u paraqit asnjë ankesë nga ky operator ekonomik, as ne formë shkresore nëpërmjet protokollit dhe as në rrugë elektronike nëpërmjet sistemit të e-albania*”[...].

II.8. Në datën 12.01.2024, nr. 2872/5 prot., Komisioni i Prokurimit Publik i dërgon shkresë operatorit ekonomik ankimues me lëndë “Kërkesë për paraqitje provash”, ku citohet “*Me shkresën nr.11/1 prot., datë 05.01.2024, protokolluar me tonën me nr.2872/4 prot., datë 09.01.2024, është depozituar në KPP informacioni i autoritetit kontraktor lidhur me trajtimin e ankesës tuaj, citohet: “[...] Nuk u paraqit asnjë ankesë nga ky operator ekonomik as ne formë shkresore nëpërmjet protokollit dhe as në rrugë elektronike nëpërmjet sistemit të e-albania*”[...].

Sa më lart, me qëllim shqyrtimin e ankesës së paraqitur nga operatori juaj ekonomik, në zbatim të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative” dhe Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766/2021, datë 13.10.2021, “Për miratimin e rregullave ‘Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik’”, KPP e gjykon të nevojshme të kërkojë nga ana juaj paraqitjen brenda datës 18.1.2024, të dokumentacionit provues, që vërteton datën e dorëzimit të ankesës suaj pranë autoritetit kontraktor.”

II.9. Ne datën 17.01.2024, operatori ekonomik “KLAME” ShPK, nëpërmjet shërbimit postar, me shkresën protokolluar në KPP nr. 2872/6 prot, datë 19.01.2024, ka dërguar informacionin me lëndë “Përgjigje Komisionit të Prokurimeve Publike”, ku citohet [...]“*, Ne lidhje me shkresën tuaj Nr.2872/5 Prot, date 12.01.2024, nepermjet se ciles kerkoni informacion se ne cilen date kemi dorezuar ankesen tek autoriteti kontraktor, sqarojme se: Ne daten 20.11.2023, shoqeria jone ka dorezuar ankesen ne fjale, e cila eshte e aksesueshme nga autoriteti kontraktor nepermjet llogarise e-albania qe aksesohet ne seksionin "Ankesa" te faqes zyrtare*

te Kpp-se. Gjithashtu, KPP pasi ka marre ne dorezim ankesen tone, e ka skanuar dhe e ka ngarkuar ne e-albania, ku automatikisht i ka kaluar edhe autoritetit kontraktor ne llogarine e tij ne e-albania. Madje, kjo qe ne sqaruam eshte konfirmuar ne llogarine e shoqerise sone ne e-albania, ku na ka mberritur mesazh, se ankesa jo vetem qe eshte marre nga AK me 20.11.2023, por statusi i saj tregon se eshte ne shqyrtim nga AK. [...]

II.10. Me qëllim verifikimin e mëtejshëm në lidhje me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues dhe verifikimin në sistemin e ankesave elektronike, KPP iu drejtua me memon nr. 2872/7 prot., datë 24.01.2024, Sektorit të Teknologjisë së Informacionit dhe Publikimit pranë KPP-së, me përmbajtje si më poshtë vijon:

[...]Nga verifikimet e materialeve të fashikullit të shqyrtimit adminsitrativ rezulton, se ankesa nr.2872 prot., datë 20.11.2023, është paraqitur nëpërmjet shërbimit postar.

Me shkresën nr. 11/1 prot, datë 05.01.2024 me objekt: “Kthim - përgjigje”, protokolluar me tonën me nr.2872/4 prot., datë 09.01.2024, nga autoriteti kontraktor është dërguar pranë Komisionit të Prokurimit Publik, informacion në lidhje me procedurën e prokurimit. Referuar këtij informacioni, autoriteti kontraktor informon se “ [...] Ju bejmë me dije se pranë Agjensisë Shtetërore të Prokurimeve të Përqendruara nuk është paraqit asnjë ankesë nga ky operator ekonomik as në formë shresore nëpërmjet protokollit dhe as në rrugë elektronike nëpërmjet sistemit e-albania “[.]

Me shkresëm nr. 2872/5, Komisioni i Prokurimit Publik i dërgon shkresë shoqërisë KLAME SHPK me lëndë “Kërkesë për paraqitje Provash“ ku citohet“ Me shkresën nr.11/1 prot., datë 05.01.2024 , protokolluar me tonën me nr.2872/4 prot., datë 09.01.2024 , është depozituar në KPP informacioni i autoritetit kontraktor lidhur me trajtimin e ankesës tuaj, citohet: “[...] Nuk u paraqit asnjë ankesë nga ky operator ekonomik as ne formë shkresore nëpërmjet protokollit dhe as në rrugë elektronike nëpërmjet sistemit të e-albania ”[...].

Sa më lart, me qëllim shqyrtimin e ankesës së paraqitur nga operatori juaj ekonomik, në zbatim të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative” dhe Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766/2021, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave ‘Për Organizimin dhe Funksonimin e Komisionit të Prokurimit Publik’”, KPP gjykon të nevojshme të kërkojë nga ana juaj paraqitjen brenda datës 18.1.2024, të dokumentacionit provues që vërteton datën e dorëzimit të ankesës suaj pranë autoritetit kontraktor“

Me shkresën me objekt, “Përgjigje Komisionit të Prokurimeve Publike”, protokolluar me tonën me nr.2872/6 prot., datë 19.01.2024, operatori ekonomik ankimues “KLAME” SHPK ka depozituar në Komisionin e Prokurimit Publik, informacion me përmbajtje si më poshtë: “[...] Ne lidhje me shkresen tuaj Nr.2872/5 Prot, datë 12.01.2024, nepermjet se ciles kerkonti informacion se ne cilen date kemi dorezuar ankesen te autoriteti kontraktor, sqarojme se:

Ne daten 20.11.2023, shoqeria jone ka dorezuar ankesen ne fjale, e cila eshte e aksesueshme nga autoriteti kontraktor nepermjet llogarise e-albania qe aksesohet ne seksionin "Ankesa" te faqes zyrtare te Kpp-se.

Gjithashtu, KPP pasi ka marre ne dorezim ankesen tone, e ka skanuar dhe e ka ngarkuar ne e-albania, ku automatikisht i ka kaluar edhe autoritetit kontraktor ne logarine e tij ne e-albania. Madje, kjo qe ne sqaruam eshte konfirmuar ne llogarine e shoqerise sone ne e-albania ku na ka mberritur mesazh se ankesa jo vetem qe eshte marre nga AK me 20.11.2023, por statusi i saj tregon se eshte ne shqyrtim nga AK: [...]

Sa më sipër, me qëllim vijimin e shqyrtimit të mëtejshëm të ankesës nga KPP, lutem kryerjen e verifikimit nëse subjekti "KLAME" SHPK ka depozituar ankesë pranë Komisionit të Prokurimit Publik në rrugë elektronike nëpërmjet sistemit të ankesave elektronike, për procedurën e prokurimit "E hapur" me nr. REF-79117-09-06-2023, me objekt "Blerje pajisje mobilimi për Qendrat Shëndetësore të Rikonstruara' Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrotjtjes Sociale" me fond limit 35,203,770.00 leke pa TVSH, zhvilluar më datë 22.09.2023, nga autoriteti kontraktor Agjencia Shtetërore e Prokurimeve të Përqëndruara.

II.11. Me memon nr. 2872/8 prot., datë 24.01.2024, Sektori i Teknologjisë së Informacionit dhe Publikimit informon se: *"Në vijim të kërkesës për verifikim nr. 2872 prot., datë 24.01.2024, për vënien në dispozicion të informacionit nëse ankesa me nr. 2872 prot., datë 20.11.2023, për procedurën e prokurimit me Nr. REF-79117-09-06-2023, me autoritet kontraktor Agjencia Shtetërore e Prokurimeve të Përqëndruar ju informojmë, se në Sistemin e Ankesave Elektronike dhe në bazë të të dhënave të mbajtura nga ne, kjo ankesë ka ardhur në rrugë shkresore, ku më pas është ngarkuar në sistem nga specialistët e Sektorit të Teknologjisë së Informacionit dhe Publikimit. Autoriteti Kontraktor, ankesat e ardhura në rrugë shkresore nuk i akseson nëpërmjet sistemit. Bashkëlidhur do të gjeni edhe një pamje që vërteton, se ankesa nuk ka ardhur me shërbim online nëpërmjet portalit e-albania".*

II.12. Në datën 14.11.2023, në formë shkresore pranë Komisionit të Prokurimit Publik, është administruar ankesa me numër ankimi me nr. 2809 prot, e operatorit ekonomik "RO-AL" SHPK, dhe pranë autoritetit kontraktor në datën 14.11.2023. Ankesa lidhet me vendimmarrjen e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi skualifikimin e ofertës së tij.

II.13. Në përputhje me nenin 112 "Veprimet paraprake" të Ligjit nr.162/2020 "Për Prokurimin Publik", Komisioni i Prokurimit Publik me marrjen e ankesës, e publikoi atë në bazën e të dhënave të tij, e cila përmban të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës), si dhe publikoi formularin e publikimit nr. 2809/2 prot, datë 14.11.2023, lidhur me kundërshtimin e vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave mbi skualifikimin e ofertës së tij.

II.14. Në datën 21.11.2023, me nr. 1438/2 prot., Autoriteti kontraktor nëpërmjet shërbimit postar me shkresën protokolluar në KPP nr. 2809/3 prot, datë 30.11.2023, ka dërguar informacionin dhe vendimin e KSHA lidhur me trajtimin e ankesës, ku kërkon zgjatje afati për shqyrtimin e ankesës së operatorit "RO-AL" SHPK.

II.15. Në datën 21.12.2023, Autoriteti Kontraktor me nr. 1438/7 prot., protokolluar me tonën 2809/4 prot., datë 29.12.2023, ka depozituar pranë Komisionit të Prokurimit Publik, në formë shkresore, informacionin lidhur me vendimmarrjen e tij lidhur me ankesën e operatorit ekonomik ankimues "RO-AL" SHPK, ku ka vendosur pranimin e saj, duke cituar *"Pranimin e ankesës së paraqitur nga operatori ekonomik", "RO-AL" SH.P.K, për vlerësimin e procedurës së prokurimit: "Procedure e hapur", me objekt "Blerje pajisje mobilerie për Qendrat*

Shëndetësore të Rikonstruara", Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, me nr. REF-79117-09-06-2023, me fond limit 35,203,770 lekë pa TVSH".

2. Personi përgjegjës për prokurimin te njoftoje për vendimin e marre ankimuesin, dhe operatorët ekonomike te interesuar brenda dites se nesërme te punes nga marrja e ketij vendimi.

3. Personi përgjegjës për prokurimin te njoftojë për vendimin e marrë Komisionin e Prokurimit Publik brenda ditës së nesërme të punës nga marrja e këtij vendimi, duke shoqëruar me shpjegimet dhe dokumentacionin përkatës.

II.16. Në formë shkresore, në datën 27.12.2023, protokolluar me tonën me nr. 2809/5 prot, datë 29.12.2023, operatori ekonomik "KLAME" SHPK dërgon shkresë pranë Komisionit të Prokurimit Publik, me lëndë "Kërkesë për informacion".

III

Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesave, dokumentacionit bashkëngjitur tyre, si dhe informacionit të autoritetit kontraktor,

Arsyeton

III.1. Lidhur me pretendimet e ngritura nga operatori ekonomik ankimues "KLAME" SHPK mbi kundërshtimin e vendimit të KVO-së në lidhje me skulifikimin e tij nga procedura e prokurimit objekt – shqyrtimi, KPP vlerëson të ndalet fillimisht në respektimin e kushteve formale të paraqitjes së ankesës nga ana e operatorit ekonomik ankimues pranë autoritetit kontraktor dhe më pas pranë Komisionit të Prokurimit Publik. Konkretisht Komisioni i Prokurimit Publik vëren se,

III.2 . Në datën 20.11.2023, në formë shkresore pranë Komisionit të Prokurimit Publik, është administruar ankesa me numër ankimi 2872, e operatorit ekonomik "KLAME". Objekti i ankesës lidhet me vendimmarrjen e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, si dhe lënien të skualifikuar të operatorit ekonomik "Ro-AI" SHPK.

III.3. Në përputhje me nenin 112 "Veprimet paraprake" të Ligjit nr.162/2020 "Për Prokurimin Publik", Komisioni i Prokurimit Publik me marrjen e ankesës, e publikoi atë në bazën e të dhënave të tij, e cila përmban të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës), si dhe publikoi formularin e publikimit nr. 2872/2 prot., datë 21.11.2023. Objekti i ankesës lidhet me lënien të skualifikuar të operatorit ekonomik "Ro-AI" SHPK.

III.4. Në datën 19.12.2023, nr. 2872/3 prot., Komisioni i Prokurimit Publik i dërgon shkresë autoritetit kontraktor, me lëndë “Mbi detyrimin e autoritetit kontraktor për dhënie informacioni KPP-së, lidhur me ankesën e operatorit ekonomik “KLAME” SHPK.

III.5. Në datën 05.01.2024, Autoriteti Kontraktor nëpërmjet shërbimit postar me shkresën nr. 11/1 prot., protokolluar në KPP me nr. 2872/4 prot., datë 09.01.2024, ka dërguar informacionin dhe vendimin e KSHA lidhur me trajtimin e ankesës së paraqitur nga operatorët ekonomikë ankimues “KLAME” SHPK, ku citon “*Nuk u paraqit asnjë ankesë nga ky operator ekonomik as ne formë shkresore nëpërmjet protokollit dhe as në rrugë elektronike nëpërmjet sistemit të e-albania*”[...].

III.6. Në datën 12.01.2024, nr. 2872/5 prot., Komisioni i Prokurimit Publik i dërgon shkresë operatorit ekonomik ankimues me lëndë “Kërkesë për paraqitje provash”, ku citohet “*Me shkresën nr.11/1 prot., datë 05.01.2024 , protokolluar me tonën me nr.2872/4 prot., datë 09.01.2024, është depozituar në KPP informacioni i autoritetit kontraktor lidhur me trajtimin e ankesës tuaj, citohet: “[...] Nuk u paraqit asnjë ankesë nga ky operator ekonomik as ne formë shkresore nëpërmjet protokollit dhe as në rrugë elektronike nëpërmjet sistemit të e-albania*”[...].

Sa më lart, me qëllim shqyrtimin e ankesës së paraqitur nga operatori juaj ekonomik, në zbatim të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative” dhe Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766/2021, datë 13.10.2021, “Për miratimin e rregullave ‘Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik’”, KPP gjykon të nevojshme të kërkojë nga ana juaj, paraqitjen brenda datës 18.1.2024, të dokumentacionit provues që vërteton datën e dorëzimit të ankesës suaj pranë autoritetit kontraktor.”

III.7. Në datën 17.01.2024, operatori ekonomik “KLAME” SHPK, nëpërmjet shërbimit postar me shkresën protokolluar në KPP nr. 2872/6 prot., datë 19.01.2024, ka dërguar informacionin me lëndë “Përgjigje Komisionit të Prokurimeve Publike” ku citohet [...], *Ne lidhje me shkresën tuaj Nr. 2872/5 Prot, date 12.01.2024, nepermjet se ciles kerkoni informacion se ne cilen date kemi dorezuar ankesen te autoriteti kontraktor, sqarojme se: Ne daten 20.11.2023, shoqeria jone ka dorezuar ankesen ne fjale, e cila eshte e aksesueshme nga autoriteti kontraktor nepermjet llogarise e-albania qe aksesohet ne seksionin "Ankesa" te faqes zyrtare te Kpp-se. Gjithashtu, KPP pasi ka marre ne dorezim ankesen tone, e ka skanuar dhe e ka ngarkuar ne e-albania, ku automatikisht i ka kaluar edhe autoritetit kontraktor ne llogarine e tij ne e-albania. Madje, kjo qe ne sqaruam eshte konfirmuar ne llogarine e shoqerise sone ne e-albania, ku na ka mberritur mesazh, se ankesa jo vetem qe eshte marre nga AK me 20.11.2023, por statusi i saj tregon se eshte ne shqyrtim nga AK. [...]*

III.8. Me qëllim verifikimin e mëtejshëm në lidhje me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues dhe verifikimin në sistemin e ankesave elektronike, KPP iu drejtua me memon nr. 2872/7 prot., datë 24.01.2024, Sektorit të Teknologjisë së Informacionit dhe Publikimit pranë KPP-së, me përmbajtje si më poshtë vijon:

[...]Nga verifikimet e materialeve të fashikullit të shqyrtimit administrativ rezulton, se ankesa nr.2872 prot., datë 20.11.2023 është paraqitur nëpërmjet shërbimit postar.

Me shkresën nr. 11/1 prot, datë 05.01.2024 me objekt: “Kthim përgjigje”, protokolluar me tonën me nr.2872/4 prot., datë 09.01.2024, nga autoriteti kontraktor është dërguar pranë Komisionit të Prokurimit Publik, informacion në lidhje me procedurën e prokurimit. Referuar këtij informacioni, autoriteti kontraktor informon, se “[...] Ju bëjmë me dije se pranë Agjencisë Shtetërore të Prokurimeve të Përqendruara nuk është paraqit asnjë ankesë nga ky operator ekonomik as në formë shkresore nëpërmjet protokollit dhe as në rrugë elektronike nëpërmjet sistemit e-albania “[..]

Me shkresën nr. 2872/5, Komisioni i Prokurimit Publik i dërgon shkresë shoqërisë KLAME SHPK me lëndë “Kërkesë për paraqitje Provash“, ku citohet “Me shkresën nr.11/1 prot., datë 05.01.2024, protokolluar me tonën me nr.2872/4 prot., datë 09.01.2024, është depozituar në KPP informacioni i autoritetit kontraktor lidhur me trajtimin e ankesës tuaj, citohet: “[...] Nuk u paraqit asnjë ankesë nga ky operator ekonomik as ne formë shkresore nëpërmjet protokollit dhe as në rrugë elektronike nëpërmjet sistemit të e-albania ”[...].

Sa më lart, me qëllim shqyrtimin e ankesës së paraqitur nga operatori juaj ekonomik, në zbatim të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative” dhe Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766/2021, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksonimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, KPP gjykon të nevojshme të kërkojë nga ana juaj, paraqitjen brenda datës 18.1.2024, të dokumentacionit provues që vërteton datën e dorëzimit të ankesës suaj pranë autoritetit kontraktor. “

Me shkresën me objekt ,“Përgjigje Komisionit të Prokurimeve Publike”, protokolluar me tonën me nr.2872/6 prot., datë 19.01.2024, operatori ekonomik ankimues “KLAME” SHPK ka depozituar në Komisionin e Prokurimit Publik informacion me përmbajtje si më poshtë: “[...]

Ne lidhje me shkresën tuaj Nr.2872/5 Prot, date 12.01.2024, nepermjet se ciles kerconi informacion se ne cilen date kemi dorezuar ankesen te autoriteti kontraktor, sqarojme se:

Ne datën 20.11.2023, shoqëria jone ka dorezuar ankesën në fjale, e cila është e aksesueshme nga autoriteti kontraktor nepermjet llogarise e-albania qe aksesohet ne seksionin "Ankesa" te faqes zyrtare te KPP-se.

Gjithashtu, KPP pasi ka marrë në dorëzim ankesën tone, e ka skanuar dhe e ka ngarkuar në e-albania, ku automatikisht i ka kaluar edhe autoritetit kontraktor në logarinë e tij në e-albania. Madje, kjo që ne sqaruar është konfirmuar në logarinë e shoqërisë sone në e-albania ku na ka mbërritur mesazh se ankesa jo vetëm që është marrë nga AK me 20.11.2023, por statusi i saj tregon se është në shqyrtim nga AK: [...]“.

Sa më sipër, me qëllim vijimin e shqyrtimit të mëtejshëm të ankesës nga KPP, lutem kryerjen e verifikimit nëse subjekti “KLAME“ SHPK ka depozituar ankesë pranë Komisionit të Prokurimit Publik në rrugë elektronike nëpërmjet sistemit të ankesave elektronike, për procedurën e prokurimit “E hapur” me nr. REF-79117-09-06-2023, me objekt “Blerje pajisje mobilimi për Qendrat Shëndetësore të Rikonstruara’ Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale” me fond limit 35,203,770.00 leke pa TVSH, zhvilluar me datë 22.09.2023, nga autoriteti kontraktor Agjencia Shtetërore e Prokurimeve të Përqendruara.

III.9. Me memon nr. 2872/8 prot., datë 24.01.2024, Sektori i Teknologjisë së Informacionit dhe Publikimit informon se: “Në vijim të kërkesës për verifikim nr. 2872 prot., datë 24.01.2024, për vënien në dispozicion të informacionit nëse ankesa me nr. 2872 prot. datë 20.11.2023, për procedurën e prokurimit me Nr. REF-79117-09-06-2023, me autoritet kontraktor Agjencia Shtetërore e Prokurimeve të Përqëndruara, ju informojmë se në Sistemin e Ankesave Elektronike dhe në bazë të të dhënave të mbajtura nga ne, kjo ankesë ka ardhur në rrugë shkresore, ku më pas është ngarkuar në sistem nga specialistët e Sektorit të Teknologjisë së Informacionit dhe Publikimit. Autoriteti Kontraktor, ankesat e ardhura në rrugë shkresore nuk i akseson nëpërmjet sistemit. Bashkëlidhur do të gjeni edhe një pamje që vërteton se ankesa nuk ka ardhur me shërbim online nëpërmjet portalit e-albania”.

III.1.10. Neni 24, pika 1, “Komisioni i Prokurimit Publik” i Ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, parashikon se: “Komisioni i Prokurimit Publik është organi më i lartë administrativ në fushën e prokurimeve, që shqyrton ankesat për procedurat e prokurimit dhe kryen çdo detyrë tjetër që i ngarkohet me këtë ligj dhe akte të tjera ligjore brenda fushës së kompetencave të tij.”.

III.1.11. Neni 30, pika 1, “Veprimtaria e Komisionit të Prokurimit Publik” i Ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, parashikon se: “Komisioni i Prokurimit Publik shqyrton ankesat e paraqitura para tij kur në mbledhje janë të pranishëm të paktën 3 nga 5 anëtarët e tij, një prej të cilëve kryetari ose nënkryetari. Në përfundim të shqyrtimit të ankesave, Komisioni vendos me shumicë votash. Vendimi deklarativ i dhënë sipas parashikimeve të nenit 115, pikat 2 dhe 3, të këtij ligji, jepet nga 3 anëtarë për procedurat e prokurimit nën kufirin e ulët monetar dhe nga 5 anëtarë për procedurat e tjera. Shqyrtimi i ankesave për procedurat e prokurimit nën kufirin e ulët monetar do të bëhet nga 3 anëtarë të Komisionit të Prokurimit Publik”.

III.1.12. Neni 110, pikat 2, 7 dhe 8 “Afatet për ankimim” i Ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, parashikon se: “2. Në procedurat e prokurimit mbi kufirin e lartë monetar, në rastin e ankesave për vendimin e vlerësimit/klasifikimit përfundimtar, operatorët ekonomikë kanë të drejtë të ankohen brenda 10 ditëve nga publikimi i njoftimit të fituesit ose publikimi i njoftimit të anulimit.

Në procedurat e prokurimit nën kufirin e lartë monetar ky afat është 7 ditë.

7. Në rast se operatori ekonomik nuk paraqet ankesën brenda afateve të parashikuara në këtë nen, atëherë nuk ka mundësi të ushtrojë më të drejtën e ankimit pranë autoritetit ose entit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

8. Të shtunat, të dielat dhe ditët e festave zyrtare nuk pengojnë fillimin dhe kohëzgjatjen e afateve. Kur dita e fundit e një afati bie e shtunë, e diel ose një ditë feste zyrtare, afati mbaron në ditën e punës që vjen pas saj. Ankesa quhet e pranuar në ditën e depozitimit të saj pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.”.

III.1.13. Neni 111, pika 1, i Ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, parashikon se: “1. Operatori ekonomik ankimues dërgon njëkohësisht ankesën në autoritetin ose entin kontraktor dhe Komisionin e Prokurimit Publik. Rregulla të posaçme për mënyrën e paraqitjes së ankesës përcaktohen në rregullat e prokurimit publik.”.

III.1.14. Neni 112, pikat 1 dhe 2 i Ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, parashikon se: “1. Me marrjen e ankesës, autoriteti ose enti kontraktor konfirmon në databazën e të dhënave të publikuara nga Komisioni i Prokurimit Publik që ankesa është paraqitur pranë këtij institucioni. Nëse autoriteti ose enti kontraktor konstaton se ankesa nuk është paraqitur në Komisionin e Prokurimit Publik, e refuzon atë si të pavlefshme.

2. Pasi konfirmon se ankesa është paraqitur në Komisionin e Prokurimit Publik, autoriteti ose enti kontraktor pezullon vazhdimin e procedurës së prokurimit deri në shqyrtimin plotësisht të ankesës, përfshirë edhe nxjerrjen e një vendimi nga Komisioni i Prokurimit Publik.”

III.1.15. Në nenin 114, pikat 1 dhe 4, “Trajtimi i ankesës nga autoriteti ose enti kontraktor” të Ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, parashikohet shprehimisht se: “1. Në rastet e ankesave për dokumentet e tenderit, autoriteti ose enti kontraktor duhet të shprehet në lidhje me ankesën e paraqitur brenda 5 ditëve nga momenti i konfirmimit të regjistrimit të saj nga Komisioni i Prokurimit Publik.

Në rastet e ankesave për vendimin e përzgjedhjes së kandidatëve pas fazës së parakualifikimit ose për procesin e vlerësimit të ofertave, autoriteti ose enti kontraktor duhet të shprehet për ankesën e paraqitur brenda 5 ditëve nga përfundimi i afatit kohor në dispozicion të operatorëve ekonomikë të interesuar, sipas parashikimeve në nenin 113 të këtij ligji, për paraqitjen e argumenteve të tyre.

“4. Në çdo rast, autoriteti ose enti kontraktor vë në dijeni për vendimin e marrë Komisionin e Prokurimit Publik, ankuesin, operatorët ekonomikë të interesuar brenda ditës së nesërme të punës nga marrja e këtij vendimi, duke e shoqëruar me shpjegimet dhe dokumentacionin përkatës.”.

III.1.16. Neni 118, “Vendimet e Komisionit të Prokurimit Publik” i Ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, parashikon shprehimisht se: “1. Komisioni i Prokurimit Publik, në çdo kohë pas marrjes së ankesës dhe para lidhjes së kontratës, kur nuk vendos pezullimin, mund ta lejojë autoritetin ose entin kontraktor, me anë të një vendimi të ndërmjetëm deri në marrjen e një vendimi përfundimtar, të vazhdojë procedurën e prokurimit nëse pezullimi dëmton tërthorazi interesin publik, autoritetin ose entin kontraktor ose ofertuesit.

2. Përpara lidhjes së kontratës, Komisioni i Prokurimit Publik ka të drejtë:

a) të refuzojë ankesën, për shkak të mosplotësimin të elementeve të domosdoshme për shqyrtimin e saj, sipas parashikimeve të nenit 111 të këtij ligji;

b) të pranojë ankesën dhe të urdhërojë autoritetin ose entin kontraktor të anulojë plotësisht ose pjesërisht një veprim ose vendim, të nxjerrë në kundërshtim me ligjin;

c) të refuzojë ankesën dhe të lejojë autoritetin ose entin kontraktor të vazhdojë procedurën e prokurimit, kur gjykon se nuk ka shkelje të dispozitave ligjore;

ç) të nxjerrë vendim deklarativ për mbylljen e çështjes, sipas parashikimeve të pikave 2 dhe 3 të nenit 115 të këtij ligji;

d) të refuzojë ankesën, e cila ka si objekt kundërshtimin e një vendimi të dhënë nga Komisioni i Prokurimit Publik, në rast të një ankesë tjetër që i përket të njëjtës procedurë, të paraqitur nga i njëjti operator ekonomik”.

III.1.17. Referuar bazës ligjore të sipërcituar, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, Operatori ekonomik ankimes dërgon njëkohësisht ankesën në autoritetin ose entin kontraktor dhe Komisionin e Prokurimit Publik. Në rastin konkret, operatori ekonomik ankimes “KLAME” SHPK ka dorëzuar ankesë vetëm pranë Komisionit të Prokurimit Publik më datë 20.11.2023, dhe nr. 28872 prot.. Referuar informacionit dhe dokumentacionit të paraqitur nga autoriteti kontraktor, si dhe nga verifikimet e kryera në Sistemin e Ankesave Elektronike, konstatohet, se operatori ekonomik ankimes “KLAME” SHPK ka dorëzuar ankesë vetëm pranë Komisionit të Prokurimit Publik. Autoriteti kontraktor, informon, se “ [...]Nuk u paraqit asnjë ankesë nga ky operator ekonomik as ne formë shkresore nëpërmjet protokollit dhe as në rrugë elektronike nëpërmjet sistemit të e-albania”[...]. Komisioni i Prokurimit Publik, me qëllim gjykimin e drejtë të ankesës së paraqitur, në zbatim të ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative”, si dhe Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766/2021, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave ‘Për Organizimin dhe Funksonimin e Komisionit të Prokurimit Publik’”, me anë të shkresës nr. 2872/5 prot., datë 12.01.2024 , i kërkoi operatorit ekonomik ankimes që brenda datës 18.01.2024, të dorëzonte pranë Komisioni të Prokurimit Publik çdo provë dhe fakt që vërtetonte dorëzimin e ankesës me shkrim apo nëpërmjet sistemit të ankesave elektronike pranë autoritetit kontraktor.

Operatori ekonomik ankimes, i cili, si palë e interesuar në proces, referuar nenit 82, pika 1, të ligjit 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative i RSh”, i ndryshuar, ka barrën e provës të vërtetojë, se kur e ka dorëzuar ankesën me shkrim apo nëpërmjet sistemit të ankesave elektronike nga portali e-albania pranë autoritetit kontraktor, njëkohësisht me atë të dorëzuar pranë Komisionit të Prokurimit Publik. Nga verifikimi i informacionit të dorëzuar nga operatori ekonomik për këtë fakt rezulton, se ky i fundit nuk ka paraqitur dokument që të vërtetojë këtë fakt, por citon, “*Ne lidhje me shkresën tuaj Nr.2872/5Prot, date 12.01.2024, nepermjet se ciles kerkoni informacion se ne cilen date kemi dorezuar ankesen tek autoriteti kontraktor, sqarojme se: Ne daten 20.11.2023, shoqeria jone ka dorezuar ankesen ne fjale, e cila eshte e aksesueshme nga autoriteti kontraktor nepermjet llogarise e-albania qe aksesohet ne seksionin "Ankesa" te faqes zyrtare te Kpp-se. Gjithashtu, KPP, pasi ka marre ne dorezim ankesen tone, e ka skanuar dhe e ka ngarkuar ne e-albania, ku automatikisht i ka kaluar edhe autoritetit kontraktor ne llogarine e tij ne e-albania. Madje, kjo qe ne sqaruam eshte konfirmuar ne llogarine e shoqerise sone ne e-albania ku na ka mberritur mesazh se ankesa jo vetem qe eshte marre nga AK me 20.11.2023, por statusi i saj tregon se eshte ne shqyrtim nga AK.*” dhe print screen të printuar nga llogaria e tij në E-albania, të cilat nuk vërtetojnë që ky operator ekonomik të ketë bërë ankesën nëpërmjet sistemit të ankesave elektronike nga portali E-albania, pasi mesazhi i dërguar te mesazhet e operatorit në llogarinë në E-albania nuk nënkupton që ky operator ekonomik ka bërë një ankesë nëpërmjet sistemit të ankesave elektronike nga portali E-albania, por është një mesazh që njofton operatorët ekonomikë pas ankesave të dorëzuara fizikisht pranë Komisionit të Prokurimit Publik. Një fakt të tillë e vërteton dhe verifikimi i kryer nga ana e sektorit të shërbimeve mbështetëse pranë Komisionit të Prokurimit Publik, i cili nëpërmjet memos së datës 24.01.2024, citon se, “Me memon nr. 2872/8 prot., datë 24.01.2024, Sektori i Teknologjisë së Informacionit dhe Publikimit informon se: “*Në vijim të kërkesës për verifikim nr. 2872 prot., datë 24.01.2024, për vënien në dispozicion të informacionit nëse ankesa me nr. 2872 prot., datë 20.11.2023, për procedurën e prokurimit me Nr. REF-79117-09-06-2023, me autoritet kontraktor Agjencia Shtetërore e Prokurimeve të*

Përqendruara ju informojmë se në Sistemin e Ankesave Elektronike dhe në bazë të të dhënave të mbajtura nga ne, kjo ankesë ka ardhur në rrugë shkresore, ku më pas është ngarkuar në sistem nga specialistët e Sektorit të Teknologjisë së Informacionit dhe Publikimit. Autoriteti Kontraktor, ankesat e ardhura në rrugë shkresore nuk i akseson nëpërmjet sistemit. Bashkëlidhur do të gjeni edhe një pamje që vërteton se ankesa nuk ka ardhur me shërbim online nëpërmjet portalit e-albania”. Sa më sipër, referuar dokumentacionit dhe informacionit të përcjellë nga autoriteti kontraktor si dhe kthim - përgjigjes së operatorit ekonomik ankimues, ky i fundit në asnjë moment, nuk vërteton që ka depozituar ankesë pranë autoritetit kontraktor. Komisioni i Prokurimit Publik sqaron, se operatori ekonomik ankimues mund të depozitojë pranë autoritetit kontraktor ankesë shkresore ose nëpërmjet sistemit elektronik të ankesave.

Sa më sipër, nga verifikimet e kryera, rezulton, se ankesa e operatorit ekonomik “KLAME” SHPK, nuk është dorëzuar pranë autoritetit kontraktor në përputhje me parashikimet e nenit 111 pika 1 të Ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, që parashikon se: “Operatori ekonomik ankimues dërgon njëkohësisht ankesën në autoritetin ose entin kontraktor dhe Komisionin e Prokurimit Publik, si dhe nenit 51, pikës 3, shkronja “a”, të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766/2021, datë 13.10.2021, “Për miratimin e rregullave “Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, çka provohet dhe konfirmohet me përgjegjësi të plotë nga autoriteti kontraktor, në shkresën e këtij të fundit të datës 05.01.2024 , si dhe nga verifikimi i sektorit të shërbimeve mbështetëse pranë Komisionit Prokurimit Publik, se ky operator ekonomik për procedurën e prokurimit objekt-shqyrtimi nuk ka paraqitur ankesë nëpërmjet sistemit të ankesave elektronike nga portali E-albania, si pranë autoritetit kontraktor ashtu dhe pranë Komisionit Prokurimit Publik. Ky mosdorëzim i ankesës njëkohësisht si pranë autoritetit kontraktor dhe pranë Komisionit Prokurimit Publik, sjell si rrjedhojë për operatorin ekonomik, mospërbushjen e detyrimit për ndjekjen e afateve dhe shkallëve të ankimit, duke mos plotësuar në këtë mënyrë njërin nga “*elementet e domosdoshëm të ankesës*”, për sa kohë ankesa e paraqitur nga operatori ekonomik ankimues pranë Komisionit të Prokurimit Publik nuk plotëson një nga kushtet formale, siç është dorëzimi i saj pranë institucionit përkatës, autoritetit kontraktor. Rrjedhimisht kjo ankesë nuk mund të merret në shqyrtim nga KPP, pasi nuk janë ezauruar të gjitha shkallët e ankimit, konkretisht njëkohësisht pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik, siç dhe parashikohet në pikën 1 të nenit 111 të LPP. Komisioni i Prokurimit Publik rithekson bindjen e tij, se për shkak të specifikës së prokurimeve publike, respektimi i shkallëve dhe afateve (ndër to dhe ai i ankimit), është i një rëndësie thelbësore e me ndikim të drejtpërdrejtë në efikasitetin e procedurës, ndaj dhe i qëndron strikt rregullimit të parashikuar nga ligji i prokurimit publik si dhe aktet nënligjore në zbatim të tij. Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se ligji *stricto sensu* ka parashikuar, se ankesa dorëzohet njëherazi si pranë autoritetit ose entit kontraktor, ashtu edhe pranë Komisionit të Prokurimit Publik dhe është përgjegjësi e operatorit ekonomik ankimues, që ta dorëzojë këtë të fundit njëherazi në të dyja institucionet, brenda afatit të parashikuar në ligj. Ky mosdorëzim përbën shkak për mospranimin e ankesës nga ana e Komisionit të Prokurimit Publik, për mungesë të kushteve formale të saj.

Akoma më tej, referuar ankesës së administruar pranë KPP-së, të operatorit ekonomik “KLAME” SHPK, bazuar në nenin 110, “Afatet për ankimit” të Ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, “Në procedurat e prokurimit mbi kufirin e lartë monetar, në rastin e ankesave për vendimin e vlerësimit/klasifikimit përfundimtar, operatorët ekonomikë kanë të

drejtë të ankohen brenda 10 ditëve nga publikimi i njoftimit të fituesit ose publikimi i njoftimi të anulimit.

Në procedurat e prokurimit nën kufirin e lartë monetar ky afat është 7 ditë.

7. Në rast se operatori ekonomik nuk paraqet ankesën brenda afateve të parashikuara në këtë nen, atëherë nuk ka mundësi të ushtrojë më të drejtën e ankimit pranë autoritetit ose entit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

8. Të shtunat, të dielat dhe ditët e festave zyrtare nuk pengojnë fillimin dhe kohëzgjatjen e afateve. Kur dita e fundit e një afati bie e shtunë, e diel ose një ditë feste zyrtare, afati mbaron në ditën e punës që vjen pas saj. Ankesa quhet e pranuar në ditën e depozitimit të saj pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.”., Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se afati për dorëzimin e ankesës pranë KPP-së dhe autoritetit kontraktor, në procedurat e prokurimit mbi kufirin e ulët monetar, në rastin e ankesave për vlersimin, është 7 ditë nga publikimi i njoftimit të fituesit.

Në rastin konkret, referuar verifikimeve në Sistemin Elektronik të Prokurimit, u konstatua, se nga ana e autoritetit kontraktor është publikuar njoftimi i fituesit paraprak në datën 10.11.2023, ndërkohë që për këtë procedurë prokurimi, operatori ekonomik ankimues “KLAME” SHPK, ka dorëzuar ankesë me shkrim pranë Komisionit të Prokurimit Publik, në datën 20.11.2023 .

Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se operatori ekonomik ankimues ka dorëzuar ankesë pas afatit të parashikuar nga neni 110, pika 1 e Ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik.

Referuar parashikimeve të sipërcituara, llogaritja e afatit për ankim pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, nis ditën e publikimit të njoftimit të fituesit paraprak dhe përfundon ditën e shtatë. Në rastin konkret, afati maksimal i paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe njëkohësisht pranë Komisionit të Prokurimit Publik është data 16.11.2023

Për sa më sipër, ankesa e depozituar në KPP, në datën 20.11.2023, konsiderohet e paraqitur pas afatit të fundit ligjor të ankimimit, duke mos u legjitimuar racione temporis. Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se ligji stricto sensu ka parashikuar, se ankesa dorëzohet njëherazi, si pranë autoritetit ose entit kontraktor, ashtu edhe pranë Komisionit të Prokurimit Publik dhe është përgjegjësi e operatorit ekonomik ankimues, që ta dorëzojë këtë të fundit njëherazi në të dyja institucionet, brenda afatit të parashikuar në ligj. Sa më sipër arsyetuar, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon, se ankesa e dorëzuar nga operatori ekonomik ankimues, nuk ka përmbushur gjithashtu detyrimin për ndjekjen e afateve ligjore të ankimimit.

III.2. Lidhur me pretendimet operatorit ekonomik “RO-AL” SHPK, duke kundërshtuar vendimin e KVO-s mbi skualifikimin e ofertës së tij në procedurën e prokurimit të sipërcituar, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se,

III.2.1. Me shkresën nr. 1438/7 prot, datë 21.12.2023, protokolluar me tonën me nr. 2809/4 prot., datë 29.12.2023, autoriteti kontraktor ka njoftuar Komisionin e Prokurimit Publik lidhur me trajtimin e ankesës të paraqitur nga operatori ekonomik”RO-AL” SHPK për procedurën e mësipërme të prokurimit, ku rezulton, se autoriteti kontraktor ka pranuar plotësisht ankesën, si

më poshtë vijon: “Pranimin e ankeses së paraqitur nga operatori ekonomik” “RO-AL” ShPK për vlerësimin e procedurës së prokurimit: “Procedurë e hapur”, me objekt “Blerje pajisje mobilierie për Qendrat Shëndetësore të Rikonstruara’ Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale me nr. REF-79117-09-06-2023, me fond limit 35,203,770 lekë paTVSH”.

2. Personi përgjegjës për prokurimin të njoftoje për vendimin e marre ankimuesin, dhe operatorët ekonomikë të interesuar, brenda ditës së nesërme të punës nga marrja e këtij vendimi.

3. Personi përgjegjës për prokurimin të njoftojë për vendimin e marrë Komisionin e Prokurimit Publik brenda ditës së nesërme të punës nga marrja e këtij vendimi, duke shoqëruar me shpjegimet dhe dokumentacionin përkatës”.

III.2.2. Neni 30 i LPP-së parashikon shprehimisht se: *Komisioni i Prokurimit Publik shqyrton ankesat e paraqitura para tij kur në mbledhje janë të pranishëm të paktën 3 nga 5 anëtarët e tij, një prej të cilëve kryetari ose nënkryetari. Në përfundim të shqyrtimit të ankesave, Komisioni vendos me shumicë votash. Vendimi deklarativ i dhënë sipas parashikimeve të nenit 115, pikat 2 dhe 3, të këtij ligji, jepet nga 3 anëtarë për procedurat e prokurimit nën kufirin e ulët monetar dhe nga 5 anëtarët për procedurat e tjera.*

III.2.3. Neni 114 pika e ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik” i cili parashikon shprehimisht se: *1. Në rastet e ankesave për dokumentet e tenderit, autoriteti ose enti kontraktor duhet të shprehet në lidhje me ankesën e paraqitur brenda 5 ditëve nga momenti i konfirmimit të regjistrimit të saj nga Komisioni i Prokurimit Publik.*

Në rastet e ankesave për vendimin e përzgjedhjes së kandidatëve pas fazës së parakualifikimit ose për procesin e vlerësimit të ofertave, autoriteti ose enti kontraktor duhet të shprehet për ankesën e paraqitur brenda 5 ditëve nga përfundimi i afatit kohor në dispozicion të operatorëve ekonomikë të interesuar, sipas parashikimeve në nenin 113 të këtij ligji, për paraqitjen e argumenteve të tyre.

2. Në rastin kur për shqyrtimin e ankesës autoriteti ose enti kontraktor ka nevojë të kryejë verifikime pranë organeve të tjera, afati i përcaktuar në pikën 1 të këtij neni ndërpritet dhe rifillon pasi të ketë siguruar informacionin e kërkuar. Në çdo rast, për pritjen e informacionit të kërkuar afati nuk duhet të tejkalojë 30 ditë.

Në çdo rast, autoriteti ose enti kontraktor ka detyrimin të vërë menjëherë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik, ankuesin dhe operatorët ekonomikë të interesuar për zgjatjen e afatit.

3. Në përfundim të shqyrtimit të ankesës sipas parashikimeve në këtë nen, autoriteti ose enti kontraktor mund të vendosë:

a) pranimin e plotë të ankesës;

b) pranimin e pjesshëm të ankesës;

c) refuzimin e ankesës.

4. Në çdo rast, autoriteti ose enti kontraktor vë në dijeni për vendimin e marrë Komisionin e Prokurimit Publik, ankuesin, operatorët ekonomikë të interesuar brenda ditës së nesërme të punës nga marrja e këtij vendimi, duke e shoqëruar me shpjegimet dhe dokumentacionin përkatës.

5. Kundër vendimit të autoritetit ose entit kontraktor, operatorët ekonomikë të interesuar, të cilët kanë paraqitur argumentet e tyre në lidhje me ankesën, kanë të drejtën të ankohen pranë

Komisionit të Prokurimit Publik brenda 5 ditëve nga marrja e njoftimit nga autoriteti ose enti kontraktor, sipas pikës 4 të këtij neni.

6. Nëse operatorët ekonomikë të interesuar nuk kanë paraqitur ankesë sipas pikës 5 të këtij neni, ata nuk do të kenë të drejtë të paraqesin më pas një ankesë për veprimet e autoritetit ose entit kontraktor

III.2.4. Neni 115 pika 1 dhe 3 e ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik” i cili parashikon shprehimisht se: *Komisioni i Prokurimit Publik shqyrton ankesën e paraqitur, si dhe vendimin e autoritetit ose entit kontraktor, së bashku me dokumentet dhe shpjegimet shoqëruese, që mbështesin këtë vendim si më poshtë:*

a) në rastet kur autoriteti ose enti kontraktor ka vendosur pranimin pjesërisht të ankesës, Komisioni i Prokurimit Publik vazhdon shqyrtimin:

i. për pjesën e ankesës/pretendimeve që nuk janë pranuar;

ii. e ankesës/ankesave për pjesën që është pranuar, nëse ka ankesa nga operatorët ekonomikë të interesuar, të cilët kanë paraqitur argumentet e tyre për këtë pjesë në përputhje me nenin 113 të këtij ligji;

b) në rastet kur autoriteti ose enti kontraktor ka vendosur pranimin e plotë të ankesës, Komisioni i Prokurimit Publik do të vijojë shqyrtimin e ankesës, nëse ka ankesë nga operatorët ekonomikë të interesuar, të cilët kanë paraqitur argumentet e tyre në lidhje me ankesën në përputhje me nenin 113 të këtij ligji;

c) në rastet kur autoriteti ose enti kontraktor ka vendosur mos pranimin e ankesës.

3. Në rastin kur autoriteti ose enti kontraktor pranon plotësisht ankesën, Komisioni i Prokurimit Publik:

a) nxjerr një vendim deklarativ për mbylljen e çështjes brenda 3 ditëve nga marrja e vendimit të dhënë nga autoriteti ose enti kontraktor për këtë ankesë, nëse operatorët ekonomikë të interesuar nuk kanë paraqitur argumentet e tyre sipas pikës 1 të nenit 113 të këtij ligji;

b) nxjerr një vendim deklarativ për mbylljen e çështjes brenda 3 ditëve nga përfundimi i afatit kohor të përcaktuar në pikën 5 të nenit 114 të këtij ligji, nëse operatorët ekonomikë të interesuar, që kanë paraqitur argumentet sipas pikës 1 të nenit 113 të këtij ligji, nuk kanë ankimuar vendimin e dhënë nga autoriteti ose enti kontraktor.

III.2.5. Nga shqyrtimi i informacionit të administruar me anë të shkresës nr. 1438/7 prot, datë 21.12.2023, protokolluar me tonën me nr. 2809/4 prot., datë 29.12.2023, KPP konstaton, se autoriteti kontraktor Agjencia Shtetërore e Prokurimeve të Përqëndruara, e ka pranuar ankesën e operatorit ekonomik ankimues për procedurën e prokurimit objekt-shqyrtimi. Në këto kushte, bazuar në pikën 3 gërma “a” të nenit 115, të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Komisioni i Prokurimit Publik do të mbyllë çështjen administrative për ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “RO-AL” ShPK.

Për sa më sipër, në mbështetje të neneve 30 pika 1, 115 pika 1 dhe 3, si dhe nenit 118 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, Vendimit të

Këshillit të Ministrave nr. 236, datë 20.04.2023 “Për përcaktimin e tarifës dhe të rregullave për pagimin e saj, në një procedurë ankimi, pranë Komisionit të Prokurimit Publik”, Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766/2021, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Nenit 4, të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendosi:

1. Të mos pranojë ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “KLAME” SHPK, lidhur me procedurën e prokurimit “E hapur” me nr. REF-79117-09-06-2023, me objekt “Blerje pajisje mobilimi për Qendrat Shëndetësore të Rikonstruara’, Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale”, me fond limit 35,203,770.00 lekë pa TVSH, zhvilluar më datë 22.09.2023, nga autoriteti kontraktor Agjencia Shtetërore e Prokurimeve të Përqëndruara.
 2. Të mbyllë çështjen për ankesën e paraqitur nga “RO-AL” SHPK për procedurën e prokurimit “E hapur” me nr. REF-79117-09-06-2023, me objekt “Blerje pajisje mobilimi për Qendrat Shëndetësore të Rikonstruara’ Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale”, me fond limit 35,203,770.00 lekë pa TVSH, zhvilluar më datë 22.09.2023, nga autoriteti kontraktor Agjencia Shtetërore e Prokurimeve të Përqëndruara.
 3. Autoriteti Kontraktor lejohet të vijojë me hapat e mëtejshëm të procedurës së prokurimit.
 4. Ngarkohet zyra e financës të kryejë veprimet përkatëse për derdhjen në Buxhetin e Shtetit, të tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “KLAME” SHPK.
 4. Ngarkohet zyra e financës, që të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga “RO-AL” SHPK
 5. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit
 6. Kopje e këtij vendimi t’i dërgohet Agjencisë së Prokurimit Publik.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nënkryetar
Florent Zguro

Anëtar
Anila Malaj

Anëtar
Kreshnik Ternova

Kryetar
Jonaïd Myzyri

